

**Raporti Nr. 99247-XK**

## **Republika e Kosovës**

**Projekti energjetik i Kosovës (i propozuar,  
P118287) dhe Financimi i dytë shtesë për  
Projektin e pastrimit të sektorit të energjisë  
dhe bonifikimit të tokave (P131539)**

### **Paneli Inspektues**

### **Raporti dhe Rekomandimi**

**2 shtator 2015**

**Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë:** Përkthimet e dokumenteve të Panelit Inspektues dhe të Menaxhmentit nuk janë përkthime zyrtare dhe ofrohen vetëm si shërbim për palët e interesit. Janë bërë të gjitha përpjekjet që përkthimi të jetë i saktë. Në rast të ndonjë mospërputhje midis përkthimit në gjuhën shqipe dhe tekstit origjinal në gjuhën angleze, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

## **Paneli Inspektues**

### **Raporti dhe rekomandimi për Kërkesën për inspektim**

#### **Republika e Kosovës: Projekti energjetik i Kosovës (i propozuar, P118287) dhe Financimi i dytë shtesë për Projektin e pastrimit të sektorit të energjisë dhe bonifikimit të tokave (P131539)**

#### **A. Hyrje**

1. Më 12 qershor 2015, Paneli Inspektues (“Paneli”) ka pranuar një kërkesë për inspektim (“Kërkesa”) të nënshkruar nga qytetarët që përfaqësojnë fshatrat Shkabaj dhe Hade, si dhe Komunën e Obiliqit (“Parashtruesit e kërkesës”) dhe nga tri organizata të shoqërisë civile me seli në Kosovë, të cilët përfaqësojnë qytetarët e prekur.<sup>1</sup> Nënshkruesit e kërkesës e kanë emëruar znjsh. Dajana Berisha të Forumit për iniciativa qytetare (FIQ) si përfaqësuese të tyre.

2. Kërkesa ngritë çështje lidhur me aktivitetet e mbështetura në kuadër të Projektit për pastrim të sektorit të energjisë dhe bonifikimit të tokës – Financimi i dytë shtesë (CLRP-SAF) dhe Projektit energjetik të Kosovës (PEK). CLRP-SAF-i mbështet përgatitjen e Vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) për Projektin e propozuar energjetik të Kosovës dhe monitorimin e zhvendosjes së lagjes Shala të fshatit Hade nga ana e Bankës, i cili realizohet përmes Planit të veprimit për zhvendosje (PVZH) të hartuar në kuadër të Projektit të përfunduar të ndihmës teknike për energjinë elektrike nga linjiti (LPTAP), të mbështetur nga Banka. Sipas parashtruesve të kërkesës, zhvendosja e fshatit Hade, së bashku me zhvendosjen e familjeve të tjera nga fshatrat tjera të zonës së njëjtë synon të mundësojë realizimin e PEK-së së propozuar. Parashtruesit e kërkesës së bashku me kërkesën kanë parashtruar dy shtojca në mbështetje të pohimeve të tyre<sup>2</sup>.

3. Paneli e ka regjistruar Kërkesën më 30 qershor 2015 dhe ka marrë përgjigjen e menaxhmentit më 31 korrik 2015.

---

<sup>1</sup>Kërkesa është nënshkruar nga tre qytetarë përfaqësues të komunitetit Shala (i zhvendosur në vitin 2006 dhe i rivendosur në Shkabaj/Hade të Re), nga komuniteti i cili ende banon në Hade si dhe nga komuniteti i cili është dëbuar nga Shala në vitin 2004. Gjithashtu, kërkesa është nënshkruar nga Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), si dhe Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID).

<sup>2</sup> Dokumenti i parë i bashkëngjitur është një raport i titulluar: “A është zhvendosja e detyruar e kosovarëve, e propozuar nga Projekti energjetik i Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvendosje jo-vullnetare?” nga Dr. Theodore E. Downing (i referuar në përgjigjen e menaxhmentit si “Raporti i Downing-ut”, dhe dokumenti i dytë është një komunikim ndërmjet Bankës dhe Konsorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile lidhur me zhvendosjen e banorëve nga fshati Hade.

4. Ashtu siç është theksuar në njoftimin për regjistrim, PEK-ja e propozuar ishte objekt i një kërkesë të mëhershme për inspektim të pranuar nga Paneli në mars të vitit 2012. Paneli konstatoi se kërkesa i përmbushte kushtet e pranueshmërisë por nuk ka rekomanduar hetim për dy arsye: PEK-ja ishte në fazën e hershme përgatitore dhe nuk ka pasur veprimtari aktive të Bankës në lidhje me shqetësimet të cilat do të mund të shqyrtoheshin nga Paneli, dhe (ii) në lidhje me çështjet e zhvendosjes, Paneli vërejti se Korniza e politikës së zhvendosjes (KPZH) dhe Plani i veprimit të zhvendosjes (PVZH) për lagjen Shala të Hades ishte përgatitur me financim nga LPTAP-i i mbyllur pasi që atë kohë Banka ende nuk e kishte miratuar CLRP-SAF-i. Relevanca e rekomandimit paraprak për rastin aktual dhe pyetja nëse janë prezantuar apo jo provat e reja analizohen në Seksionin E të këtij raporti.

5. Në përputhje me Rezolutën për themelimin e Panelit Inspektues<sup>3</sup>, qëllimi i këtij raporti dhe rekomandimi është që t'i ofrojë rekomandime Bordit të drejtorëve ekzekutiv nëse Paneli duhet të hetojë çështjet që pohohen në këtë kërkesë. Rekomandimi i Panelit bazohet në shqyrtimin e pranueshmërisë teknike të kërkesës dhe në vlerësimin e faktorëve të tjerë, të cilët pasqyrohen në Rezolutën e Panelit dhe në procedurat operative të tij.<sup>4</sup>

6. Ky dokument jep përshkrim të projekteve të cilat janë objekt i kërkesës (seksioni B), përmbledhje të kërkesës (seksioni C), përmbledhje të përgjigjes së menaxhmentit (seksioni D) si dhe konstatimin e Panelit përkitazi me pranueshmërinë teknike të kërkesës së bashku me vërtetimet e tyre (seksioni E). Rekomandimi i Panelit paraqitet në seksionin F.

## **B. Përshkrimi i projekteve relevante**

7. **Projekti i pastrimit të sektorit energjetik dhe bonifikimit të tokave – Financimi i dytë shtesë (CLRP-SAF).** CLRP-i është miratuar më 13 qershor 2006 në shumën prej SDR 3.8 milionë (të barasvlershme me 5.3 milionë USD). Banka miratoi Financimin e parë shtesë më 28 qershor 2007 në shumën prej SDR 3.3 milionë (të barasvlershme me 4.6 milionë USD). Financimi i dytë shtesë (CLRP-SAF, që është objekt i kërkesës) është miratuar më 10 maj 2013 në shumën prej SDR 2.8 milionë (të barasvlershme me 3.9 milionë USD). Data e mbylljes së CLRP-SAF-it është vazhduar deri më 29 shkurt, 2016 (shih tabelën 1 në vijim ku janë dhënë operacionet e ndryshme të cilat i mbështet Banka në sektorin energjetik në Kosovë).

8. CLRP-SAF-i ka pikësynimet vijuese: (i) të shtjellojë çështjet mjedisore të trashëguara në lidhje me hedhjen në hapësirë të hapur të hirit në tokë nga termocentrali Kosova A në pronësi të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), (ii) t'i mundësojë KEK-ut që tokat aktualisht të mbuluara me material të vihen në dispozicion për qëllime zhvillimore të komunitetit dhe të trajtohet deponia e hirit të Kosovës A, dhe (iii) të iniciohen operacionet strukturore përbrenda KEK-ut për operacione të vazhdueshme të pastrimit dhe praktika të mira mjedisore gjatë

<sup>3</sup>Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim (Rezoluta nr. IDA93-6), "Paneli Inspektues i Bankës Botërore", 22 shtator, 1993 (në tekstin e mëtejshëm "Rezoluta"), para 19. Gjetet në: <http://siteresources.worldbank.org/EXTINSPECTIONPANEL/Resources/ResolutionMarch2005.pdf>

<sup>4</sup>Procedurat operative të Panelit Inspektues, prill 2014. Gjetet në: <http://ewebapps.worldbank.org/apps/ip/PanelMandateDocuments/2014%20Updated%20Operating%20Procedures.p>

operacioneve të mihjes. CLRP-SAF-i ka zgjeruar pikën e tretë të pikësnyimeve të projektit për të “mbështetur KEK-un dhe [Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor] që të zbatojë operacione të vazhdueshme pastrimi dhe praktika të mira mjedisore në sektorin energjetik dhe të minierave.” CLRP-SAF-i financon: (i) pajisjet për monitorim të ajrit për të matur të dhënat fillestare të cilësisë së ajrit, (ii) monitorim të dheut dhe ujit për të mbledhur të dhëna lidhur me gjendjen fillestare të ndotjes së ujit dhe ajrit, (iii) vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) për PEK-në, i cili propozohet për mbështetje nga Banka përmes një Garancie të pjesshme të riskut në kuadër të PEK-së, (iv) monitorim të zbatimit të PVZH-së për lagjen Shala të fshatit Hade nga QK-ja; (v) Paneli ndërkombëtar i ekspertëve mjedisor dhe social; dhe (vi) një studim mbi rritjen e ultë të karbonit. Komponentet (iii) dhe (iv) janë relevante për pohimet e parashtruesve të kërkesës.

9. LPTAP-i, i cili është mbyllur më 31 dhjetor 2011 ishte një projekt i ndihmës teknike me synim përgatitjen e dokumenteve të ndryshme sociale dhe mjedisore, specifike për zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë, duke përfshirë vlerësimin strategjik mjedisor dhe social (VSMS), Draft planin për zhvillimin e fushës së re të mihjes (PZHFRM), dhe kornizën e politikës së zhvendosjes (KPZH) për zhvendosjet eventuale që do të realizohen në zonën e fushës së re të mihjes (e cila mbulon fushën e Mihjes të Sibovcit)<sup>5</sup>. LPTAP-i gjithashtu financoi PVZH-në për lagjen Shala të fshatit Hade, e cila gjendet në zonën e fushës së re të mihjes, bazuar në kornizën e lartcekur të politikës së zhvendosjes. LPTAP-i gjithashtu synoi ngritjen e kapacitetit të QK-së për të vlerësuar, monitoruar dhe rregulluar ndikimet mjedisore të mihjes dhe prodhimit të energjisë elektrike.

10. **Projekti energjetik i Kosovës (PEK).** PEK-ja e propozuar, aktualisht në përgatitje e sipër, synon të sigurojë: (i) furnizim të sigurtë të energjisë për ekonominë e Kosovës; (ii) përbalueshmërinë energjetike për qytetarët dhe bizneset, dhe (iii) ulje të dukshme të ndikimit mjedisor dhe social të prodhimit të energjisë elektrike. Pikësynimet kyçe të projektit janë të ofrojë zgjidhje afatgjate për nevojat për energji elektrike në Kosovë dhe të vë në zbatim standardet e Bashkimit Evropian për efikasitet dhe mbrojtje të mjedisit gjatë punës së termocentralit të ri të propozuar.

11. Sipas Dokumentit informativ të projektit të vitit 2011 (DIP), PEK-ja do të ofrojë Garanci të pjesshme të riskut (GPR) për të ndihmuar me zëvendësimin e termocentralit Kosova A me një termocentral të rehabilituar ekzistues (Kosova B) dhe ndërtimin e termocentralit Kosova e Re (TCKR, i njohur gjithashtu edhe si Kosova C), si dhe zhvillimin e një miniere për të përmbushur nevojat e këtyre impianteve për karburant.<sup>6</sup>

12. Në përgjigjen e vet, menaxhmenti jep një status të azhurnuar të projektit duke qartësuar që komponentët të cilat më herët ishin në shqyrtim përmes GPR-së, përkatësisht: (i) rehabilitimi i termocentralit Kosova B; dhe, (ii) zhvillimi i mihjes së linjtit në fushën e Sibovcit, janë refuzuar në fillim të vitit 2014. Sipas menaxhmentit, termocentrali i ri do të mund të furnizohej me linjit nga

---

<sup>5</sup>Paneli vëren se fusha e mihjes në Sibovc, zona e përfshirë në zonën me interes të veçantë ekonomik dhe zona e mbuluar nga drafti i planit zhvillimor për fushën e re të mihjes gërshetohen në masë të madhe.

<sup>6</sup>Dokumenti i informatave të projektit (DIP), faza e konceptit, projekti energjetik i Kosovës, 27 korrik 2011, Banka Botërore, fq. 21.

Sibovci (fusha e re e mihjes). <sup>7</sup> Menaxhmenti shton se VNMS-ja (financuar nga CLRP-SAF) është duke studiuar lokacione alternative të mihjes së linjtit në Kosovë për të furnizuar TCKR-në.

13. Sipas përgjigjes së menaxhmentit, Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor është duke finalizuar draftin e VNMS-së për PEK-në e propozuar dhe për aktivitetet e ndërlidhura. Të gjitha fazat e procesit përgatitor të VNMS-së, përfshirë draftin e VNMS-së, pritet t’iu nënshtrohen konsultimeve të gjera publike. Menaxhmenti vë në pah se vendimi për të vazhduar me garancinë e pjesshme të riskut për PEK-në e propozuar nuk është marrë ende dhe do të varet, ndër të tjera, edhe nga vlerësimi ekonomik, financiar, mjedisor dhe social si dhe nga respektimi i politikave të mbrojtjes mjedisore dhe sociale. <sup>8</sup>

**Tabela 1 – Pasqyra e angazhimit të bankës në sektorin energjetik në Kosovë**

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Projektet e financuara nga Banka	ESTAP* (Miratimi prill 2001 – mbyllja dhjetor 2002)		ESTAP2 (Miratimi qershor 2003 – Mbyllja shtator 2005)		Gërshetimi ndërmjet ESTAP2 dhe ESTAP3		ESTAP (Miratimi mars 2005 – Mbyllja qershor 2008)				PEK Data e dokumentit koncept janar 2011, Dokumenti informativ i projektit (DIP) korrik 2011						
							LPTAP (Miratimi tetor 2006 – mbyllja dhjetor 2012)		LPTAP-AF (Miratimi qershor 2007 – Mbyllja dhjetor 2012)								
							CLRP (Miratimi qershor 2006 – mbyllja dhjetor 2006 – vazhduar me CLRP-SAF)		CLRP-AF Pastrimi i Lokacionit të gasfikimit (aprovimi qershor 2007 – Mbyllja dhjetor 2010 – vazhduar me CLRP-SAF)		CLRP (Miratimi i 1 qershor 2012 – mbyllja dhjetor 2014 – vazhduar me CLRP-SAF)		CLRP-SAF (Miratimi maj 2013 – mbyllja qershor 2015 – vazhduar deri më shkurt 2016)				

<sup>7</sup>Përgjigja e menaxhmentit, para. 21.

<sup>8</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe7.

Aupute të financuara nga Banka	<u>ESTAP</u> Studimi i sektorit energjetik	<u>ESTAP2</u> Korniza për investime private në sektorin energjetik	<u>ESTAP3</u> - Strategjia e sektorit të xehetarisë - Korniza e politikës për komunikim, pjesëmarrje për komunitetet që mund të preken nga projektet e ardhshme.	<u>LPTAP</u> - SESA - KPZH - Projekt amendamentet e Ligjit për eksproprijim - Drafti i Planit zhvillimor të fushës së re të mihjes - PVZH –ja për lagjen Shala të fshatit Hade	<u>CLRP-SAF</u> -Mbikëqyrja e zbatimit të PVZH-së dhe financimi i raporteve të monitorimit të PVZH-së (në vazhdim e sipër)
					Përgatitja e VNMS-së (në vazhdim e sipër)

*Burimi: Përgjigja e menaxhmentit dhe Panelit Inspektues*  
\*ESTAP:Projekti i ndihmës teknike për sektorin energjetik

### C. Përmbledhja e kërkesës

14. Kërkesa (bashkëngjitur si Aneksi I) paraqet pohime për disa dëmtime të cilat parashtruesit e kërkesës besojnë se rrjedhin nga mbështetja e Bankës, përfshirë KPZH-në e financuar nga Banka, e cila përcakton standardin për çfarëdo zhvendosje eventuale, si dhe për PVZH-në për zhvendosjen aktuale të lagjes “Shala” dhe monitorimin e saj. Ata gjithashtu pohojnë se dëmet mund të përkeqësohen nëse nuk adresohen si duhet në analizën dhe studimet e mbështetura nga CLRP-SAF-i dhe të kryera si pjesë e VNMS-së për PEK-në.

15. **Humbja e tokës, mjeteve të jetesës dhe mirëqenies.** Parashtruesit e kërkesës pohojnë se kanë humbur dhe do të humbin tokë, mjete të jetesës dhe mirëqenien si rezultat i mos-respektimit të politikave të Bankës nga vetë Banka “*në programin e vet të ndihmës teknike për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës në përgatitjen e kornizës së politikave, asaj ligjore dhe rregullatore për të na zhvendosur me detyrim dhe për t’i hapur rrugën termocentralit të ri të thëngjillit të financuar nga Banka.*” Ata gjithashtu pohojnë se me “*dizajnimin dhe zbatimin*” e zhvendosjes së lagjes Shala të fshatit Hade, “*veprimet në mospërputhje të Bankës kanë përkeqësuar rreziqet sociale*” ndaj tyre dhe ndaj PEK-së së propozuar, pasi që ky i fundit “*është duke u zhvilluar pa inkorporuar në tërësi planifikimin e plotë të zhvendosjes së detyrueshme dhe hulumtimin paraprak financiar të cilat është dashur të shoqërojnë një zhvendosje të tillë të detyrueshme të shkallës së madhe.*”

16. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se zhvendosja po kryhet për shkak se fshati Hade gjendet në minierën e Sibovcit (zona e fushës së re të mihjes) në periferi të fushës jugore të mihjes në Sibovc. Fusha jugore e mihjes është duke u zgjeruar për të nxjerrë linjit për termocentralet ekzistuese Kosova A dhe B dhe eventualisht për TCKR-në e propozuar, për të cilin është duke u përgatitur VNMS-ja në kuadër të CLRP-SAF.

17. **Zhvendosja e detyrueshme.** Parashtruesit e kërkesës pohojnë se “*si rezultat e ndihmës jo të duhur teknike të Bankës*”, pjesë të komunitetit të tyre janë zhvendosur me detyrim sipas një PVZH-je i cili nuk është në përputhje me politikën e Bankës Botërore apo me standardet ndërkombëtare. Kjo zhvendosje, sipas parashtruesve të kërkesës, gjatë dekadës ka shkaktuar

*“pasiguri të madhe”* në komunitetin e tyre pasi që ata kanë vuajtur nga varfëria, mungesa e strehimit, pasiguria e ushqimit, mungesa e tokës, papunësia dhe stresi. Parashtruesit e kërkesës janë të shqetësuar se në të ardhmen do t’i përjetojnë po të njëjtat dëme ashtu si anëtarët e tjerë të zhvendosur të komunitetit Shala.

18. **Kufizimet në zhvillimin ekonomik.** Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pohojnë se Banka *“ka inkurajuar apo ndihmuar”* Qeverinë e Kosovës, në kuadër të programit të saj për ndihmë teknike, që të caktojë një zonë të veçantë të interesit ekonomik për qëllime të ndërtimit të PEK-së së propozuar. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se kjo zonë cenon të drejtën e tyre për tokë dhe zhvillim ekonomik dhe se është realizuar pa bërë vlerësim të ndikimit dhe pa ndjekur procesin e duhur (gjegjësisht, *“njoftim dhe pjesëmarrje domethënëse dhe me kohë”*). Ata pohojnë se ky zonim nënkupton *“marrjen faktike të tokës sonë, duke na kufizuar jetën dhe mjetet e jetesës”* pa kompensim apo rikthim të mjeteve të jetesës. Sipas tyre, ky zonim është duke shkaktuar *“shpopullim”* të kësaj zone duke qenë se ata nuk mund t’i strehojnë familjet apo të kultivojnë të lashtat apo të kenë mjete jetese të qëndrueshme. Ata argumentojnë se ky zonim është pjesë e procesit të zhvendosjes së detyrueshme në mospajtim me Politikën e Bankës mbi zhvendosjen e detyrueshme.

19. **Barra financiare.** Parashtruesit e kërkesës shtojnë se duke mos inkorporuar pikësynimet e Politikës mbi zhvendosjen e detyrueshme dhe duke mos ofruar *“burime të mjaftueshme për investim”* për të përmbushur këto pikësynime, kostoja e zhvendosjes së vazhdueshme të Hades dhe zhvendosjet e tjera të mundshme në kuadrin e PEK-së së propozuar, është duke iu bartur anëtarëve të komunitetit dhe *“tatimpaguesve”* të Kosovës.

20. **Raporti i Downing-it.** Kërkesës i është bashkëngjitur si aneks një raporti i quajtur *“A është zhvendosja e detyruar e kosovarëve, e propozuar nga Projekti energjetik i Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvendosje jo-vullnetare?”* i shkurtit 2014 dhe i hartuar nga eksperti për zhvendosje jo-vullnetare z. Theodore Downing (në përgjigjen e menaxhmentit i quajtur *“Raporti i Downing-ut”*).

21. Raporti pohon se familjet e prekura janë duke u zhvendosur me detyrim duke aplikuar një strategji të zhvendosjes të para një dekadë, të quajtur *“Zgjerimi gradual i mihjes dhe marrja e tokës”* apo *“Strategjia SMELT”*. Strategjia SMELT gradualisht *“amputon”* pjesë të vendbanimeve, disa shtëpi apo ndonjëherë një lagje të tërë përnjëherë. Ajo vepron në zona me popullsi të dendur, duke i afruar operacionet e mihjes pranë vendbanimeve dhe ndonjëherë duke i futur disa qindra metra brenda tyre. Sipas këtij raporti, strategjia e tillë i vendos interesat e mihjes mbi ato të zhvillimit duke shpërndarë kostot e investimit për blerje të tokës gjatë tërë ciklit jetësor të fushës së mihjes, dhe duke arsyetuar zhvendosjen e detyrueshme me interesin e sigurisë dhe shëndetit publik, *“si zgjidhje për problemin që fillimisht vetë mihja e ka shkaktuar”*.

#### **D. Përmbledhja e përgjigjes së menaxhmentit**

22. Menaxhmenti në përgjigjen e vet (bashkëngjitur si Aneksi II) pohon se asnjë projekt në sektorin e ehëtarisë dhe energjetikës i mbështetur nga Banka në Kosovë nuk kërkonte zhvendosje. Nisur nga kjo, ata pohojnë se dëmet e cekura në kërkesë nuk rrjedhin nga mos-përputhshmëria e veprimeve të Bankës me politikën dhe procedurat e veta apo nga këshillat teknike të Bankës.

Menaxhmenti gjithashtu thekson se ndikimet negative të cekura në kërkesë nuk kanë gjasa të rrjedhin nga PEK-ja e propozuar. Përkundrazi, mbështetja e Bankës ka ndihmuar në ngritjen e kapacitetit të Kosovës për të menaxhuar zhvendosjen për shkak të mihjes, duke çuar kështu në përmirësime të dukshme në praktikën e zhvendosjes.

23. Përgjigja e menaxhmentit vë në pah se parashtruesit e kërkesës pohojnë gabimisht se aktivitete aktuale dhe të ardhshme të mihjes janë të ndërlidhura ekskluzivisht me PEK-në e propozuar. Menaxhmenti shpjegon se mihja kryhet edhe për termocentralet tashmë operative: Kosova A dhe Kosova B, dhe se “do të vazhdojë me apo pa PEK-në e propozuar”<sup>9</sup>. Ata pohojnë se kërkesa nuk bën dallimin në mënyrë të duhur midis aktiviteteve dhe përgjegjësive të Qeverisë dhe atyre të Bankës. Këtu përfshihet kufizimet e ndërtimeve, të cilat rrjedhin nga themelimi i Zonës me interes të veçantë ekonomik.

24. Menaxhmenti pajtohet se zhvendosja në të kaluarën, e cila daton para angazhimit të Bankës, ka shkaktuar ndikim negativ tek njerëzit e prekur. Banka është duke u angazhuar me Qeverinë e Kosovës për të ndihmuar në përmirësimin e praktikave të saj dhe për të mbështetur ngritjen e kapaciteteve. Menaxhmenti ka vënë në pah se kërkesa është e ndërlidhur me (i) mënyrën dhe procesin e zhvendosjes jovullnetare nga Qeveria për veprimtaritë e mihjes në Kosovë; dhe (ii) kufizimet në ndërtim dhe zhvillim ekonomik për komunitetet të cilat jetojnë në zonën me interes të veçantë ekonomik dhe të cilat mund të zhvendosen në të ardhmen.

25. Përgjigja e menaxhmentit i referohet kërkesës së qershorit të vitit 2004 nga Institucionet e përkohshme të vetë-qeverisjes (IPVQ) në lidhje me evakuimin emergjent të familjeve për shkak të rrezikut iminent të shembjes së dheut të shkaktuar nga trashëgimia e praktikave të dobëta të mihjes. Menaxhmenti shpjegon se pas kësaj kërkesë, më 4-5 korrik, 2004, Banka ka dërguar në Kosovë një mision të përbërë nga dy persona për të “ndarë përvojën e Bankës në zhvendosje, për të ofruar këshilla mbi politika, dhe për të ndihmuar në përgatitjen e termave të referencës për konsulentët e zhvendosjes, të cilët do të rekrutohen nga autoritetet.”<sup>10</sup> Sipas menaxhmentit, nuk ka pasur misione të tjera të Bankës në lidhje me evakuimin emergjent.

26. Sipas menaxhmentit, më 3 nëntor 2004, Qeveria e Kosovës themeloi një Zonë të interesit të veçantë ekonomik si pjesë e vendimeve më të gjera të Qeverisë në lidhje me mihjen në faza të depozitave të linjtit në fushën e re të mihjes (“një hapësirë e madhe e mihjes së linjtit e cila përfshin minierën jugore të Sibovcit, e cila ofron linjit për dy termocentralet ekzistuese [Kosova A dhe Kosova B] dhe të cilat gjithashtu mund të siguronin linjit edhe për TCKR-në e propozuar”<sup>11</sup>). Menaxhmenti shpjegon se ky vendim, me datë, është para përfshirjes së Bankës nëpërmjet LPTAP-it<sup>12</sup>. Zona me interes të veçantë ekonomik fillimisht përfshinte fshatrat Hade, Sibovc, Leshkoshiq dhe Cerkevna Vodice, si dhe Komunën e Obiliqit. Më 13 mars 2009, Qeveria shqyrtoi dhe zgjeroi këtë Zonë për të mbuluar të gjithë Fushën e re të mihjes. Ky vendim hyri në fuqi kur Kuvendi i Kosovës miratoi Planin hapësinor të Qeverisë në tetor 2011. Menaxhmenti pohon se Banka nuk ka financuar ndihmën teknike, të ndërlidhur me Zonën me interes të veçantë ekonomik. Mirëpo,

<sup>9</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe vii.

<sup>10</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe7.

<sup>11</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe8.

<sup>12</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe63, nr. 18.



VNMS-ja për PEK-në e propozuar financohet në kuadrin e CLRP-SAF-it, dhe është duke e shqyrtuar *“kornizën ligjore relevante të vendit dhe duke vlerësuar çështjet relevante, përfshirë çështjet që rrjedhin nga themelimi i Zonës me interes të veçantë ekonomik*<sup>13</sup>.

27. Në Përgjigjen e vet menaxhmenti ka vënë në dukje se në kuadër të LPTAP-it të mbyllur, Banka ka financuar hartimin e dokumenteve strategjike, të cilët synojnë të fuqizojnë aftësitë rregullatorë të vendit, të cilat lidhen me garancitë mjedisore dhe sociale dhe përmirësimin e kapacitetit të autoriteteve relevante. Prandaj, LPTAP-i ka mbështetur hartimin e Vlerësimit strategjik mjedisor dhe social (VSMS), draftin e Planit zhvillimor të fushës së re të mihjes (PZHFRM) dhe KPZH-në për fushën e re të mihjes për t’u siguruar që blerja e tokës dhe zhvendosja e detyrueshme janë në përputhje me politikën operacionale 4. 12. Sipas menaxhmentit, përgatitja e KPZH-së ishte kryer me konsultime të gjera me komunitete lokale dhe me palët kyçe të interesuara. Menaxhmenti argumenton se duke qenë se nuk ka pasur zhvendosje si pasojë e projektit të mbështetur nga Banka, Banka nuk ka obligim që të mbikëqyrë KPZH-në apo zbatimin tij.

28. Menaxhmenti ka shpjeguar se zgjerimi i mihjes është hequr nga Garancia e pjesshme e riskut për PEK-në<sup>14</sup>. Prandaj, përkundër asaj që është paraparë në KPZH, zhvendosja nuk është më përgjegjësi e investitorit privat. Ky ndryshim në fushëveprim kërkon azhurnimin e KPZH-së për të ndarë qartazi përgjegjësitë ndërmjet subjekteve publike. KPZH-ja e azhurnuar gjithashtu do të inkorporojë mësimet e nxjerra nga zbatimi i parë i KPZH-së në zhvendosjen e lagjes “Shala”. Sipas menaxhmentit, KPZH-ja e Shalës ishte gjithashtu një rezultat i ndihmës teknike të financuar nga LPTAP-i dhe është përgatitur në përputhje me KPZH-në. Me kërkesë të Qeverisë, Banka aktualisht është duke financuar monitorimin e zbatimit të KPZH-së së Shalës përmes CLRP-SAF-it.

29. Menaxhmenti shpjegon se KPZH-ja e Shalës është bazuar në konsultime të gjera me njerëzit e prekur, duke shtuar se zhvendosja u paraqit si nevojë për shkak të nxjerrjes së linjtit të nevojshëm për termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Në kuadër të CLRP-SAF-it janë përgatitur dy raporte publike të monitorimit nga një firmë ndërkombëtare e zhvendosjes. Këto raporte të monitorimit ofrojnë dëshmi se të 63 familjet e zhvendosura fizikisht kanë marrë kompensim, dhe se 52 familjet që janë orientuar për truall në Shkabaj, që është shumë më afër Prishtinës (5 km) sesa Hades (14 km), kanë marrë titull pronësie për pronën e tyre të re. Që nga korriku i vitit 2015, janë kërkuar dhe lëshuar 48 leje të ndërtimit, 21 shtëpi janë në ndërtim e sipër dhe 12 familje janë vendosur në shtëpi të reja. Sipas menaxhmentit, kushtet e jetesës në lokacionin e ri janë më të mira pasi që banorët nuk pritet t’iu ekspozohen ndikimeve nga veprimtaritë e mihjes.

30. Menaxhmenti deklaron se janë identifikuar sfidat që kanë dalë nga zbatimi i KPZH-së, i janë bërë me dije Qeverisë dhe se janë duke u adresuar. Menaxhmenti shton se Raporti mbi përfundimin e zhvendosjes është në përgatitje e sipër dhe do të shpaloset. Menaxhmenti konsideron se përvoja nga zbatimi i KPZH-së vë në pah fushat për përmirësim për KPZH-të e ardhshme, siç

---

<sup>13</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe13.

<sup>14</sup>Përgjigja e menaxhmentit thotë *“Komponentet e mëhershme të PEK-së së propozuar (rehabilitimi i termocentralit Kosova B, dhe zhvillimi i minierës së linjtit në Sibovcin jugor) janë hedhur poshtë nga Komiteti drejtues i projektit të propozuar në fillim të vitit 2014, për shkak të vështirësive të pritura me sigurimin e financimit të duhur,”* faqe 22, nr. 1.

janë: qartësimi lidhur me matricën e të drejtave; afatet më të qarta kohore për zhvendosje, dhe vlerësimi më i hollësishëm i kapacitetit zbatues të Qeverisë.

31. Lidhur me Raportin e Downing-it, Menaxhmenti ka deklaruar se ai është një prej dokumenteve referues i cili është në analizim e sipër, si pjesë e procesit të VNMS-së. Për më tepër, përgjigja e menaxhmentit përmban një aneks përmes të cilit ata iu përgjigjen në mënyrë të hollësishme pohimeve të Raportit të Downing-it.

32. Menaxhmenti gjithashtu deklaroi se në prill të vitit 2014, është informuar se QK është zotuar për zbatimin e zhvendosjes në Shipitulle dhe se është duke bërë përpjekje për të siguruar shërbimet e një firme ndërkombëtare të zhvendosjes për të ndihmuar me përgatitjet, zbatimin dhe monitorimin e një PVZH-je të re për Shipitullen (e cila gjendet në Fushën e re të mihjes). Në fillim të korrikut të vitit 2015, Banka është njoftuar se komuniteti i Grabovcit të Poshtëm, i cili gjendet në skajin e jashtëm të Fushës së re të mihjes, ka shprehur shqetësime rreth ndikimeve që ndërlidhen me afërsinë e tij me operacionet e mihjes, duke ngritur kështu shqetësime lidhur me çështjen e zonave tampon dhe shmangien e ndikimeve tek komunitetet të cilat gjenden në afërsi të gropës së mihjes. Menaxhmenti ka deklaruar se edhe kjo çështje është duke u shtjelluar dhe vlerësuar në kuadër të VNMS-së nga CLRP-SAF-i.

33. Përgjigja e menaxhmentit i referohet projektit të ri të mundshëm të financuar nga Banka, Projekti i mihjes së qëndrueshme nga aspekti mjedisor dhe social, të cilin Banka është duke e diskutuar me Qeverinë pasi që në vitin 2014 është marrë vendimi që fusha e mihjes të mos privatizohet. Ky projekt gjithashtu ka mundur të përfshijë zhvillimin e infrastrukturës publike për Shkabajn e Ri (për përgatitje të 400-600 parcelave të tjera për nevoja të zhvendosjes për 10-15 vitet e ardhshme) dhe ngritje të kapacitetit, planifikimin dhe monitorimin për zhvendosje për shkak të mihjes, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e komunitetit në komunën xehtare të Obliqit, si dhe restaurimin e minierave të shpenzuara të Mirashit që gjenden jashtë Fushës së re të mihjes. Deri më sot, Qeveria nuk e ka kërkuar zyrtarisht një projekt të tillë.

34. Menaxhmenti arrin në përfundimin se *“mihja e linjitet në Kosovë, me nevojën e krijuar për blerje të tokës dhe zhvendosje, është duke vazhduar dhe do të vazhdojë me ose pa PEK-në e propozuar për shkak të kërkesës për linjit nga dy termocentralet ekzistuese Kosova A dhe B.”* Ata shtojnë se edhe pse Banka nuk ka vendosur nëse do ta mbështesë PEK-në e propozuar, nëse vendos ta mbështesë, *“çështjet e ngritura të zhvendosjes do të adresohen përmes instrumenteve të duhura mbrojtëse për projektin e propozuar”*. Menaxhmenti shpreh besimin e vet se Banka i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbatuar politikën dhe procedurat e veta dhe për të vepruar në pajtim me deklaratën e saj të misionit<sup>15</sup>.

## **E. Shqyrtimi i kërkesës dhe i përgjigjes së menaxhmentit nga Paneli**

35. Anëtarë i Panelit Zeinab Bashir Elbakri, Sekretarja ekzekutive Dilek Barlas, dhe Zyrtari i lartë operativ Serge Selwan e vizituan Kosovën prej 3 deri më 6 gusht të vitit 2015. Gjatë kësaj vizite, ekipi zhvilloi takime me parashtuesit e kërkesës, anëtarë të prekur të komuniteteve, zyrtarë qeveritarë nga Ministria e Financave dhe Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,

<sup>15</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe14.

përfaqësues të KEK-ut dhe përfaqësues të Komunës së Obiliqit. Ekipi gjithashtu është takuar me stafin e Bankës në Zyrën e Vendit, një përfaqësues të Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Paneli ka shprehur mirënjohje për të gjithë ata që kanë ndarë mendimet e tyre, informatat dhe dijen dhe i shpreh mirënjohje të veçantë Zyrës së Bankës Botërore për Vendin, për ndihmën me rregullimet logjistike.

36. Shqyrtimi i Panelit bazohet në informatat e prezantuara në kërkesë, përgjigjen e menaxhmentit, prova të tjera dokumentare si dhe në informatat e mbledhura gjatë vizitës në terren. Shqyrtimi i mëposhtëm mbulon konstatimin e Panelit përkitazi me pajtueshmërinë teknike të kërkesës, në përputhje me kriteret e parapara me Qartësimin e vitit 1999 (nënseksioni 1),<sup>16</sup> dhe vërtetimet mbi faktorët e tjerë në mbështetje të rekomandimit të Panelit (nënseksioni 2).

### **E.1. Përcaktimi i pranueshmërisë teknike**

37. Paneli është i kënaqur se kërkesa i plotëson të gjashtë kriteret e pranueshmërisë teknike nga paragrafi 9 i Qartësimin të vitit 1999. Paneli vë në pah se konfirmimi i pranueshmërisë teknike, që përfaqëson një tërësi të fakteve të verifikueshme, që fokusohen, në masë të madhe, në përmbajtjen e kërkesës së artikuluar nga parashtruesit e kërkesës, nuk përfaqëson vlerësimin e Panelit përkitazi me thelbin e pohimeve të parashtruara në kërkesë.

38. Kriteri (a): *“Pala e prekur përbëhet prej dy apo më shumë personave me interes apo shqetësim të përbashkët dhe të cilët janë në territorin e kredi-marrësit.”* Kërkesa është nënshkruar nga tre pjesëtarë të komunitetit dhe tri organizata të shoqërisë civile, të cilët përfaqësojnë njerëzit e prekur. Paneli konfirmon se parashtruesit e kërkesës jetojnë në territorin e kredi-marrësit dhe janë të prekur nga aktivitetet e Projektit. Paneli i konsideron si të përmbushura kushtet e paragrafit 9(a).

39. Kriteri (b): *“Kërkesa në thelb pohon se shkelja serioze e politikave dhe procedurave operacionale të Bankës, nga vetë kjo e fundit, ka apo mund të ketë ndikim negativ tek Parashtruesi i kërkesës”.* Parashtruesit e kërkesës pohojnë, në thelb, se mos-përputhshmëria me politikën e Bankës, në veçanti me ato në lidhje me zhvendosjen e detyrueshme, ka rezultuar në humbje të tokës dhe përkeqësim të mjeteve të jetesës. Pjesëtarët e komunitetit e kanë informuar ekipin e Panelit për dëmet serioze të cilat i vuajnë për shkak të mënyrës se si është planifikuar dhe zbatuar zhvendosja (kalendari për zbatimin e zhvendosjes, mungesa e infrastrukturës dhe stabilimenteve, kompensimi jo adekuat dhe ndikimet serioze në mjetet e jetesës, konsultime të cilësisë së ulët dhe mungesa e mekanizmit formal për shqyrtim të ankesave, si dhe përgjegjësitë jo të qarta institucionale). Ata gjithashtu e kanë njoftuar Panelin se vuajnë nga afërsia fizike me aktivitetet e mihjes dhe kufizimet në përdorimin e tokës për shkak të ndihmës teknike të Bankës dhe PEK-së së propozuar, e cila ka shpërfillur ndikimet sociale dhe ekonomike e të cilat janë duke shkaktuar ndikime negative në jetesë. Në këtë mënyrë, Paneli është i kënaqur se është përmbushur

---

<sup>16</sup>“Qartësimi i vitit 1999i Shqyrtimi të dytë të Bordit të Panelit inspektues”, prill 1999 (në tekstin e mëtejshëm “Qartësimet e vitit 1999

”) gjenden në <http://siteresources.worldbank.org/EXTINSPECTIONPANEL/Resources/1999ClarificationoftheBoard.pdf>

kushti i paragrafit 9(b).

40. Kriteri (c): *“Kërkesa pohon se lënda e saj i është bërë me dije menaxhmentit dhe se, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, menaxhmenti nuk është përgjigjur si duhet, duke dëshmuar se ka ndjekur apo është duke ndërmarrë hapa për të vepruar në pajtim me politikën dhe procedurat e Bankës.”* Paneli ka verifikuar se shqetësimet e parashtruesve të kërkesës i janë bërë me dije Bankës në raste të ndryshme para parashtrimit të kërkesës. Kështu, Paneli është i kënaqur se ky kriter është përmbushur.

41. Kriteri (d): *“Çështja nuk është e ndërlidhur me prokurimin.”* Paneli konsideron se pohimet nuk ngrenë çështje të prokurimit dhe nga kjo del se ky kriter është përmbushur.

42. Kriteri (e): *“Kredia e ndërlidhur nuk është mbyllur apo disbursuar në masë domethënëse.”* Në kohën kur është marrë kërkesa, ashtu siç është cekur edhe në Njoftimin për Regjistrim, CLRP-SAF-i është disbursuar në rreth 53%, ndërkohë që PEK-ja mbetet një projekt i propozuar.

43. Kriteri (f): *“Paneli nuk ka dhënë ndonjë rekomandim të mëhershëm lidhur me këtë lëndë ose, nëse ka dhënë, kërkesa pohon se ka prova apo rrethana të reja të cilat ishin të panjohura në kohën e kërkesës paraprake.”* PEK-ja e propozuar ka qenë lëndë e një Kërkesë më të hershme për Inspektim, e cila ishte marrë nga Paneli në mars të vitit 2012. Paneli asokohe nuk ka rekomanduar hetim për kërkesën për shkak të fazës së hershme të procesit përgatitor të projektit dhe mungesës së operacioneve të mbështetura nga Banka e që ishin relevante për shqetësimet e ngritura në Kërkesë. Paneli konfirmon, në kuadër të kërkesës aktuale për Inspektim, se ka dëshmi dhe rrethana të reja, të panjohura në kohën e kërkesës së mëhershme, përfshirë pohime për dëme të reja të pazbutura në kuadër të CLRP-SAF-it.

## **E.2. Vrojtimet e Panelit lidhur me rekomandimin e tij**

44. Në dhënien e rekomandimeve të veta Bordit dhe në përputhje me Procedurat e veta operative, Paneli merr parasysh si në vijim: nëse ka ndonjë lidhje të besueshme shkakore ndërmjet dëmit të pohuar në Kërkesë dhe Projekti; nëse dëmi i pohuar dhe mospajtueshmëria e Bankës me politikën dhe procedurat e saj operative, mund të kenë karakter serioz; dhe nëse menaxhmenti i ka adresuar si duhet çështjet në fjalë, apo ka pranuar mos-përputhshmërinë dhe ka paraqitur ndonjë deklaratë për veprimet korigjuese të cilat adresojnë shqetësimet e parashtruesve të kërkesës. Paneli cek në vijim vrojtimit paraprake lidhur me dëmin e pohuar dhe pajtueshmërinë, duke theksuar se, me këtë veprim, nuk është duke dhënë ndonjë vlerësim përfundimtar lidhur me pajtueshmërinë e Bankës me politikën dhe procedurat e saj dhe çfarëdo ndikimi material negativ që kjo gjë mund të ketë shkaktuar.

45. Paneli njih nevojat e rëndësishme të Kosovës për energji dhe përkundër rritjes së shpejtë të kërkesës, prodhimi i energjisë vazhdon të varet nga dy termocentrale të vjetruara dhe gjithnjë e më të pasigurt (Kosova A dhe Kosova B). Prandaj, duke pasur parasysh mangësitë në furnizimin rajonal, Kosova vazhdon të varet nga rezervat e saj të linjitet për prodhimin e energjisë, të cilat janë rezervat e treta më të mëdha në Evropë.

46. Gjatë vizitës së tij, ekipi i Panelit ka konstatuar tre lloje të dëmit teksa u takua me tre

grupe të parashtruesve të kërkesës nga fshati Hade afër këndit jugperëndimor të fushës së mihjes në Sibovc. Grupi i parë i dëmeve është pësuar nga një grup i përbërë nga pjesëtarë të komunitetit të cilët fillimisht jetonin në lagjen Shala të fshatit Hade dhe që janë duke u zhvendosur në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj (të quajtur “Hade e Re”). Grupin e dytë të dëmeve e ka pësuar grupi i pjesëtarëve të komunitetit të cilët ende jetojnë në Hade, por të cilët janë prekur nga shpallja e Zonës me interes të veçantë ekonomik. Në fund, Paneli u takua me grupin e tretë të anëtarëve të komunitetit të cilët pësojnë dëme si rezultat i zhvendosjes emergjente të vitit 2004 nga Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Tre grupet e ndryshme më herët ishin pjesë e një komuniteti të vetëm në fshatin Hade.

47. **Dëmet që rrjedhin nga zhvendosja e Shalës.** Pjesëtarë të komunitetit që janë zhvendosur nga lagja Shale e fshatit Hade në Shkabaj e kanë informuar ekipin e Panelit lidhur me disa dëme të cilat i vuajnë për shkak të mënyrës se si është planifikuar dhe zbatuar zhvendosja.

48. *Kalendari i zhvendosjes.* Parashtruesit e kërkesës e kanë informuar ekipin e Panelit lidhur me vonesat domethënëse dhe të vazhdueshme në procesin e zhvendosjes dhe ndikimet negative të këtij procesi në jetën e tyre. Ata kanë thënë se procesi i zhvendosjes ka filluar në vitin 2011. Mirëpo, pothuajse katër vite më vonë, komuniteti i prekur ende nuk ka lokacion të mirëfilltë të zhvendosjes, me infrastrukturë funksionale, mbi të cilin mund të ndërtojnë shtëpitë e tyre. Ata kanë shpjeguar se pas dhënies së pëlqimit për zhvendosje, në vitin 2011, kanë nënshkruar Marrëveshjen trepalëshe me Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Komunën e Obiliqit; mirëpo, zhvendosja nuk ka ndjekur as kushtet e kësaj kontrate dhe as ato të Planit të veprimit për zhvendosje (PVZH), të financuar nga Banka Botërore.

49. Parashtruesit e kërkesës i kanë komunikuar ekipit të Panelit se, duke qenë se lokacioni për zhvendosje nuk ishte gati, ndërkohë që mihjet po vazhdonin në afërsi të shtëpive të tyre, ata ishin zhvendosur në ambiente të përkohshme banimi dhe u është ofruar qira emergjente dhe ndihmë me ushqime. Ata shpjeguan se jetojnë në banesa të përkohshme që nga viti 2011 ose 2012, për shkak të vonesave në përgatitjen e lokacionit për zhvendosje. Vetëm në fund të vitit 2014, i kanë marrë parcelat dhe kanë filluar ndërtimin e shtëpive. Paneli e kupton se nga 63 familje, të cilat ishin zhvendosur fizikisht, 52 prej tyre kanë vendosur të marrin tokë zëvendësuese në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj. Deri më sot, sipas komunitetit, janë ndërtuar 23 shtëpi dhe 11 familje janë vendosur në shtëpitë e tyre të reja.

50. *Infrastruktura dhe stabilimentet.* Familjet të cilat janë vendosur në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj janë ankuar për infrastrukturën e pakompletuar, të nevojshme për të përkrahur jetën e tyre të përditshme, përfshirë kanalizimin, ujin dhe rrymën. Ata i kanë treguar ekipit të Panelit se duhet të kalojnë nëpër parcela të fqinjëve për t’u kyçur në rrjete të energjisë elektrike dhe të ujit. Ata vunë në pah se kanalizimi nuk ishte dizajnuar si duhet, duke qenë se gypat janë me diametër të vogël. Sipas tyre, kjo tashmë ka shkaktuar bllokim dhe vërshime në dy shtëpi gjatë këtij sezonit me shi. Ata gjithashtu i treguan ekipit të Panelit gjendjen e rëndë të rrugëve dytësore në lokacion.

51. Pjesëtarët e komunitetit gjithashtu kanë ngritur shqetësime lidhur me mungesën e stabilimenteve, siç janë shkolla fillore dhe ambulanca afër lokacionit të zhvendosjes. Ata deklaruan se fëmijët e tyre duhet të bëjnë rrugë të gjatë më këmbë për të shkuar në shkollën fqinje dhe

shprehën shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë e fëmijëve të vegjël. Ata ngritën shqetësime lidhur me pasigurinë e tyre nëse këto stabilimente do t’iu ofrohen. Ata shpjeguan se një numër i madh i familjeve të mbetura ngurojnë të vendosen në lokacionin e zhvendosjes për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe ndjenjës së komunitetit, për të cilën besojnë se ende nuk është rivendosur në lokacionin e ri.

52. *Kompensimi dhe ndikimi në jetesë.* Pjesëtarët e komunitetit njoftuan ekipin e Panelit se edhe pse Komuna e Obiliqit ka ofruar Shkabajn si lokacion të zhvendosjes, ata është dashur ta mbulojnë diferencën monetare të vlerës ndërmjet parcelave të tyre në lagjen Shala dhe vlerën e parcelave në Shkabaj (kjo diferencë vlerësohet në 12,500 EUR). Ata deklaruan se kompensimi është ofruar në bazë të vlerësimit të tokës dhe pasurisë, të realizuar në vitin 2004, në kuadër të Marrëveshjes trepalëshe të vitit 2011, por se shumat e pranuar nuk pasqyrojnë vlerën reale të pasurisë së tyre dhe as nuk kanë marrë parasysh rritjen e kostos së materialit ndërtimor për shkak të vonesave në marrjen e parcelave të ndara.

53. Pjesëtarë të komunitetit gjithashtu pohuan se para zhvendosjes, çdo familje ka përfituar nga burime të ndryshme të të hyrave dhe mjeteve të jetesës, përfshirë të hyra dhe mjete jetese nga bujqësia, si dhe nga pagat e punësimit të një apo më shumë anëtarëve të familjes në KEK. Ata e njoftuan Panelin se, si pjesë e marrëveshjes së vitit 2011, KEK-u është dashur të punësojë 20 anëtarë të komunitetit. Mirëpo, kjo pjesë e marrëveshjes nuk është zbatuar në tërësi. Ata gjithashtu deklaruan se parcelat e pranuar në Shkabaj janë më të vogla se ato që i kishin në Shala. Prandaj, me humbjen e tokës bujqësore, ata kanë humbur një pjesë të burimit të jetesës. Ata pohuan se jetesa e tyre vuan si pasojë e zhvendosjes dhe janë ankuar për mungesën e masave përcjellëse për rikthimin e mjeteve të jetesës.

54. Pjesëtarë të komunitetit gjithashtu e kanë njoftuar ekipin e Panelit se gjatë zhvendosjes së përkohshme ndërmjet viteve 2012 dhe 2014, atyre u janë dhënë ndihma emergjente në ushqime dhe qira. Kjo ndihmë, në përputhje me Marrëveshjen Trepalëshe, është dashur të vazhdojë deri në ndarjen e truallit, bartjen e pronësisë dhe përfundimin e infrastrukturës në Shkabaj. Mirëpo, ndihma është ndërprerë në prill të vitit 2014 edhe pse lokacioni i zhvendosjes ende nuk ishte gati dhe shumë familje ende ishin në banim të përkohshëm me qira.

55. *Konsultimet dhe mekanizmi formal për shqyrtimin e ankesave.* Parashtruesit e kërkesës janë ankuar për mungesë të konsultimeve, posaçërisht në fazën aktuale të zbatimit të zhvendosjes ku, sipas tyre “askush nuk i dëgjon problemet e tyre”. Ata gjithashtu kanë vënë në pah mungesën e informimit lidhur me avancimin e procesit të zhvendosjes. Ata i thanë Panelit se nuk ishin informuar asnjëherë lidhur me mekanizmin për ankesa dhe se janë përpjekur t’i ngrenë shqetësimet e tyre pranë Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, KEK-ut, Komunës së Obiliqit dhe Bankës Botërore në disa raste. Prandaj, “nuk është e qartë se ku duhet t’i komunikojnë problemet e tyre.” Paneli vuri në pah se mungesa e mekanizmit zyrtar të ankesave është njëra prej çështjeve të parashtruara qartë në raportin e dytë monitorues të PVZH-së.<sup>17</sup>

56. *Përgjegjësitë institucionale.* Parashtruesit e kërkesës janë ankuar për mungesë qartësie

---

<sup>17</sup>Plani i veprimit për zhvendosje, Lagja Shala, Projekti për Haden, Raporti i dytë monitorues i Kosovës, i shtatorit të vitit 2014.

lidhur me ndarjen e roleve dhe përgjegjësi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, KEK-ut, dhe Komunës së Obiliqit lidhur me zbatimin e aspekteve të ndryshme të procesit të zhvendosjes. Ekipi i Panelit gjithashtu ka po të njëjtin vërtetim gjatë takimeve të tij me këto institucione. Sipas parashtruesve të kërkesës, kjo mungesë qartësie ka shkaktuar vonesa dhe ndikim negativ tek pjesëtarët e komunitetit dhe procesi i zhvendosjes në përgjithësi.

57. Ashtu siç u përmend më lartë, përgjigja e menaxhmentit ka vënë në pah se sfidat lidhur me zbatimin e PVZH-së për Shalën janë identifikuar në raportet e monitorimit dhe gjatë mbikëqyrjes së Bankës. Menaxhmenti ka konsideruar se këto i janë bërë me dije Qeverisë dhe se janë duke u adresuar nga Qeveria e Kosovës.

58. **Zona me interes të veçantë ekonomik.** Grupi i dytë i dëmeve ka të bëjë me ndalesat në ndërtimin e strukturave të reja, përfshirë zgjerimin dhe përmirësimin e shtëpive ekzistuese brenda Zonës me interes të veçantë ekonomik, të krijuar për shkak të zgjerimit të fushës së mihjes në Sibovc. Ky grup i parashtruesve të kërkesës jeton në pjesën e mbetur të fshatit Hade në fushën e mihjes në Sibovc, afër këndit jugperëndimor të tij.

59. Pjesëtarët e komunitetit janë ankuar lidhur me ndikimin që ka shpallja e kësaj zone në jetesën e tyre, mirëqenien e përgjithshme, përfshirë prirjen kah shpopullimi. Gjithashtu, për shkak të afërsisë me fushën e mihjes, njerëzit që jetojnë në këtë zonë vuajnë nga zhurma dhe nga format të tjera të ndotjes. Sipas anëtarëve të komunitetit, ata as mund t'i shesin shtëpitë dhe as mund t'i vendosin familjet e tyre në rritje, për shkak të kufizimeve në shfrytëzimin e tokave të tyre. Ata i kanë thënë ekipit të Panelit se për shkak të zonimit, ata kanë pritur të zhvendosen në përputhje me kalendarin e para-caktuar për zgjerim të mihjes. Ata i thanë Panelit se, që prej një kohe mjaft të gjatë, janë duke pritur realizimin e kësaj zhvendosjeje dhe se për këtë shkak *“jeta e tyre është e ngrirë”*.

60. Ata kanë thënë se një pjesë e fshatit Hade (lagjja Shala) tashmë është rivendosur në Shkabaj, ndërkohë që janë ende me këtë status të papërcaktuar në fshatin Hade brenda Zonës me interes të veçantë ekonomik. Ata i janë ankuar Panelit se kjo gjë e ka copëtuar komunitetin e tyre.

61. Sipas përgjigjes së menaxhmentit, Qeveria e Kosovës ka themeluar Zonën me interes të veçantë më 3 nëntor të vitit 2004 përmes një vendimi të Qeverisë lidhur me mihjen në faza të depozitës së linjtit në Fushën e re të mihjes (fusha e mihjes në Sibovc) para përfshirjes së Bankës në Kosovë. Paneli vëren se fusha e mihjes në Sibovc, hapësira e përfshirë në Zonën me interes të veçantë ekonomik dhe zona e përfshirë në Planin e ri të zhvillimit të fushës së mihjes (PRZHFM) gërshetohen në masë të madhe. Zona fillimisht përfshinte fshatrat Hade, Sibovc, Leshkoshiq dhe Cerkevna Vodice si dhe Komunën e Obiliqit. Ajo është zgjeruar për të mbuluar tërë fushën e re të mihjes në vitin 2009, gjë që hyri në fuqi me miratimin e Planit hapësinor për fushën e re të mihjes nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2011. Sipas PRZHFM-së, vendbanimet të cilat ende gjenden në Fushën e re të mihjes kanë një popullsi prej afërsisht 5,600 njerëzish.<sup>18</sup>

<sup>18</sup>Drafti final i Planit zhvillimor të fushës së re të mihjes (PZHFRM), dhjetor 2008, faqet 3-4. Sipas PZHFRM-së, nuk ka shifra të sakta zyrtare të popullsisë, sepse që nga viti 1981 nuk është kryer regjistrimi i popullsisë. Mirëpo, vlerësohet se popullsia e mbetur në Hade është rreth 2,500, ajo e Shipitullës lindore 91, Lajthishtes 921, Sibovcit 114 dhe Dardhishtes 987. Nuk ka vlerësime për fshatin Plemetin.

62. Gjatë vizitës në termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe te veprimtaritë e ndërlikdhura të mihjes, ekipi i Panelit ka mundur të vërejë afërsinë e mihjes me vendbanimet, por edhe ndërlikueshmërinë e situatës në raport me ndërtimin e strukturave të reja në Zonën me interes të veçantë ekonomik. Zyrtarët e KEK-ut i kanë thënë ekipit të Panelit se ka një numër në rritje të ndërtimeve spekulative ilegale rreth zonës së mihjes, të ngritura në kundërshtim me kufizimet për shfrytëzimin e tokës; KEK-u nuk e ka kapacitetin për t'u marrë me këtë çështje.

63. **Evakuimi emergjent.** Grupi i tretë i dëmeve është pasojë e evakuimit të një pjese të fshatit Hade në vitin 2004. Ky evakuim ka ndodhur si masë emergjente pas rrezikut për rrëshqitje të mundshme të dheut në zonë, të shkaktuar nga zgjerimi i veprimtarive të mihjes. Është ndërmarrë nga UNMIK-u dhe ka përfshirë 158 familje.

64. Përfaqësuesit e këtij grupi janë ankuar lidhur me procesin e zhvendosjes, përshtatshmërinë e ndihmës kalimtare, pamundësinë e përgjithshme për të rikthyer mjetet e tyre të jetesës që prej kohës kur ndodhi evakuimi. Ata kanë vënë në dukje se ende jetojnë në banim të përkohshëm dhe se nuk kanë informata lidhur me perspektivën e së ardhmes. Ata gjithashtu e kanë njoftuar Panelin se, duke qenë se ishin pjesë e fshatit Hade, edhe ata është dashur të zhvendosen në Shkabaj. Ata pohuan se, edhe pse ishin evakuuar për shkak të emergjencës, toka e tyre ka mbetur si para njëmbëdhjetë viteve.

65. Sipas përgjigjes së menaxhmentit, këto veprime të zhvendosjes nuk ishin pjesë e operacioneve të mbështetur nga Banka. Mirëpo, në përgjigje të një kërkesë nga UNMIK-u, Banka ka dërguar një mision për të ndarë përvojën e saj lidhur me zhvendosjen dhe për të ofruar këshillim për politika dhe ndihmë në përgatitjen e termave të referencës për konsulentët e specializuar në çështjet e zhvendosjes, të cilët do të angazhohen nga autoritetet. Menaxhmenti ka vënë në pah se, për shkak të angazhimit të vazhdueshëm të Bankës në këtë Sektor, Banka e inkurajon Qeverinë e Kosovës që të zgjidhë çështjet e mbetura të këtyre familjeve të zhvendosura.

### **E.3. Shqyrtimi i Panelit**

66. Energjia ka qenë një shtyllë qendrore në angazhimin e Bankës në Kosovë që prej kohës kur vendi doli nga konflikti në vitin 1999 (shih tabelën 1). Në vitin 2000, Bankës i është kërkuar t'i ndihmojë UNMIK-ut që të hartojë një strategji afatgjate për sektorin energjetik.<sup>19</sup> Angazhimi aktiv i Bankës ka filluar me miratimin e Projektit të parë të ndihmës teknike për sektorin energjetik, në vitin 2001. Nga viti 2003 e më pas, ndihma teknike e Bankës ka përfshirë zhvillimin e kornizës dhe mbështetjen për tërheqjen e investimeve të sektorit privat në sektorin energjetik<sup>20</sup>. Në Strategjinë më e fundit të Partneritetit me vendin, e cila mbulon vitet fiskale 2012 – 2015,

<sup>19</sup>Strategjia e përkohshme e mbështetjes për Kosovën, Raporti i progresit, 27 qershor, 2000, faqe 10.

<sup>20</sup>Shih:Strategjia e përkohshme e mbështetjes e Grupit të Bankës Botërore për Kosovën. 13 prill, 2004. Aneksi IV, faqe 3. (Sektori energjetikTA2,US\$1. 5milionë. Miratuar në CY03);Strategjia e Përkohshme - Shënim për Kosovën për periudhën FY06-FY07. Faqe 19;Strategjia e Përkohshme - Shënim për Kosovën për periudhën FY08. Faqe 7“Në vitin 2007,ka filluar puna urgjente për hapjen e minierës, gjë që kërkon fonde buxhetore në shkallë edhe më të lartë. Qeveria, me mbështetje nga Banka Botërore, kërkon në mënyrë aktive investim privat si në zhvillimin e minierës së re, ashtu edhe për një termocentrali të ri me teknologji të pastër”;Strategjia e përkohshme, Shënim për Republikën e Kosovës për periudhë FY10-FY11. Faqe 24.



theksohet se “Banka do të vazhdojë me përgatitjen e mbështetjes për investimet në TCKR/Sibovc përmes ofrimit të një GPR-je [Garancie të Pjesëshme për Rrezikun] nga IDA dhe mbështetjes së mundshme plotësuese nga IFC dhe MIGA. Mbështetja e WBG-së për përmirësim të kredisë (përfshirë GPR-në) do të ofrohej mbi bazë jo-obligative, parimore (. . . ).”<sup>21</sup>

67. Në kuadër të LPTAP-it, Banka ka financuar disa studime të cilat janë pjesë e përgatitjes së PEK-së së propozuar. Përgjigja e menaxhmentit e vitit 2012 ndaj kërkesës së mëhershme për inspektim në lidhje me PEK-në, cek se përmes LPTAP-it, “Banka i ndihmoi Qeverisë që të zhvillojë një kornizë të sigurisë (. . . ) për projektin e propozuar të termocentralit prej 2000 MW të quajtur ‘Kosova C’.”<sup>22</sup> Këtu përfshihet Vlerësimi strategjik mjedisor dhe social (VSMS), i cili përqendrohet në “ofrimin e mbështetjes për mbrojtje mjedisore dhe sociale për të mundësuar zhvillimin dhe investimin e suksesshëm brenda Fushës së re të mihjes, përfshirë zhvillimin e minierës së re të linjimit dhe termocentralin, në një mënyrë e cila është konsistente me praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje me menaxhimin e ndikimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore të zhvillimeve të tilla.”<sup>23</sup> Paneli e kupton se që nga viti 2008, duke pasur parasysh shqetësimet mjedisore, sociale dhe financiare, është marrë një vendim për të ulur madhësinë e termocentralit të propozuar, nga 2000 në 600 MW për të plotësuar vetëm nevojat vendore.<sup>24</sup>

68. Krahas VSMS-së, LPTAP-i ka financuar draftin përfundimtar të planit zhvillimor të fushës së re të mihjes (PZHFRM), të dhjetorit të vitit 2008, i cili është “plan regjional i zhvillimit të sektorit energjetik, që ka për synim përshkrimin e implikimeve hapësinore të zhvillimit të minierës së re dhe termocentraleve të ndërlidhura dhe përcaktimin e gurtheleve të planifikimit hapësinor si dhe kornizën për veprimtarinë zhvillimore.”<sup>25</sup> Ashtu siç është cekur në përgjigjen e menaxhmentit, [lani hapësinor i Qeverisë për fushën e re të mihjes, i miratuar në vitin 2011 për të analizuar strategjitë e ndryshme zhvillimore për fushën e re të mihjes dhe ndikimeve të tyre teknike, ekonomike, mjedisore dhe sociale, është informuar drejtpërsëdrejti nga VSMS-ja dhe PZHFRM-i, ndër të tjera. LPTAP-i gjithashtu ka financuar Kornizën për politikën e zhvendosjes (KPZH), e cila ishte bazë për zhvendosjen e lagjes Shala.

69. Ashtu siç u përmend më lartë, monitorimi i zbatimit të PVZH-së së Shalës aktualisht financohet në kuadër të CLRP-SAF-it. CLRP-SAF-i gjithashtu mbështet përgatitjen e një VNMS-je për PEK-në. Paneli merr parasysh deklaratën e menaxhmentit se, nëse Banka vendos të mbështesë PEK-në e propozuar, miniera që ofron linjit për TCKR-në do të konsiderohet si një aktivitet i ndërlidhur dhe i shtjelluar ashtu siç parashihet në politikën e Bankës.<sup>26</sup> Menaxhmenti shton se VNMS-ja është duke ndërmarrë një analizë të ndikimeve mjedisore dhe sociale si rezultat i kësaj mihjeje, duke përfshirë masat e zbutjes.<sup>27</sup> VSMS-ja gjithashtu pritet të analizojë “skanarët e planit

<sup>21</sup>Strategjia e partneritetit me vendin për Republikën e Kosovës për periudhën FY12-FY15. Faqe 24.

<sup>22</sup>Përgjigja e menaxhmentit ndaj Shqyrtimit të Panelit Inspektues të Projektit Energjetik të Kosovës (të propozuar), 12 maj, 2012, Banka Botërore, f. 3, para 12.

<sup>23</sup>Vlerësimi strategjik mjedisor dhe social, E1367Vëllimi 3, VSMS Kosova C, faqet 1 dhe 2.

<sup>24</sup>Përgjigja e menaxhmentit ndaj Shqyrtimit të Panelit Inspektues të Projektit Energjetik të Kosovës (propozuar), 12 maj, 2012, Banka Botërore, fq. 3 para 12, fusnota 6.

<sup>25</sup>Vlerësimi strategjik mjedisor dhe social, E1367Vëllimi 3, VSMS Kosova C/SESA, faqe 2.

<sup>26</sup>Përgjigja e menaxhmentit, Para. viii, faqe vii.

<sup>27</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe 68, nr. 22.

të mihjes për nga shkalla, lokacionet dhe fazat në minierën e re (. . . ) për planet dhe fazat e zhvillimit të minierës (. . . ) për të themeluar një plan menaxhimi për zonën e mihjes dhe për të identifikuar ndikime të mundshme.”<sup>28</sup> Ashtu siç është cekur më lartë, edhe pse zgjerimi i minierës është larguar nga PEK-ja e propozuar dhe nuk do të jetë më përgjegjësi e zhvilluesit privat, zgjerimi i minierës i ndërlidhur me PEK-në dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të saj do të trajtohen nga sektori publik. Përgjigja e menaxhmentit përmend se Banka është duke diskutuar me Qeverinë e Kosovës një projekt të mundshëm mihjeje, të qëndrueshëm nga aspekti mjedisor dhe social, të financuar nga Banka për këtë qëllim.

70. Paneli vëren se zhvendosja dhe ndikimet e ndërlidhura sociale dhe ekonomike që rezultojnë nga zgjerimi i mihjes së linjtit në afërsi të vendbanimeve në Kosovë historikisht janë ndërmarrë në mënyrë të fragmentuar. Kjo është pranuar edhe në përgjigjen e menaxhmentit, e cila vë në dukje dobësitë në blerjen e tokës dhe procesin e zhvendosjes, të ndërlidhura me planifikimin joadekuat të zhvillimit të minierës.<sup>29</sup>

71. Duke pasur parasysh informatat e mbledhura nga Paneli në terren dhe shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit përkatës, Paneli vë në dukje se çështjet e dëmit, të ngritura në këtë kërkesë, janë të gjitha të një natyre serioze. Paneli më tej vë në pah se këto dëme mund të ndërlidhen në mënyrë bindëse me ndihmën teknike të Bankës dhe me aktivitetet e tjera të kryera gjatë dekadës së kaluar dhe në kuadër të aktiviteteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të cilat mbështesin përgatitjen e projektit të PEK-së për të cilin, ashtu siç u cek më lartë, Banka është zotuar të sigurojë GPR-në mbi bazën “jo obligative, parimore”.

72. Rrjedhimisht, Paneli vë në pah se ndihma teknika dhe aktivitetet e tjera të financuara nga LPTAP-i (gjegjësisht VSMS-ja, PZHFRM-i, KPZH-ja dhe PZVH-ja e Shalës) dhe nga CLRP-SAF-i (VNMS-ja e PEK-së dhe monitorimi i zbatimit të PZVH-së së Shalës) e që janë të ndërlidhura me kërkesën, mund të konsiderohen si elemente esenciale të përgatitjes së projektit për PEK-në e propozuar. Për më tepër, VNMS-ja i konsideron VSMS-në dhe PZHFRM-në (si dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura) si studime kyçe ekzistuese mjedisore dhe sociale për qëllime të vlerësimit të VSMS-së së aspekteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar të termocentralit. Ashtu siç është cekur në përkufizimin e “projektit” në Shqyrtimin e Rezolutës të vitit 1996 për themelimin e Panelit inspektues “*fjala “projekt”, ashtu siç përdoret në Rezolutë, ka po të njëjtin kuptim si ai në praktikën e përgjithshme të Bankës, dhe përfshin projekte të cilat janë në shqyrtim e sipër nga menaxhmenti i Bankës si dhe projektet e aprovuara nga drejtorët ekzekutivë.*”<sup>30</sup> Prandaj, procesi i përgatitjes për PEK-në e propozuar bie në kuadër të mandatit të Panelit.

---

<sup>28</sup>Termet e referencës – Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social (VNMS)për Projektin e propozuar Energjetik të Kosovës – i cili përbëhet nga (i) zhvillimi i termocentralit me linjit (Termocentrali “Kosova e Re” ose TCKR) në Obiliq;(ii)zhvillimi i një miniere të hapur të linjtit në Sibovcin jugor; dhe (iii) infrastrukturën përcjellëse siç janë modernizime elektrike në nënstacionin Kosova B, rezervuari i ujit dhe zona e mihjes, ku do të hidhen pluhuri dhe gipsi, fq. 13. Gjetet në: [http://mmph-rks.org/repository/docs/TOR-ESIA\\_978148.pdf](http://mmph-rks.org/repository/docs/TOR-ESIA_978148.pdf)

<sup>29</sup>Përgjigja e menaxhmentit, faqe4.

<sup>30</sup>Shqyrtimi i Parë i Rezolutës për Themelimi të Panelit Inspektues: Qartësimi i vitit 1999 i disa aspekteve të Rezolutës, paragrafi mbi “Pranueshmërinë dhe Qasjen”. Gjetet në:<http://siteresources.worldbank.org/EXTINSPECTIONPANEL/Resources/1996ReviewResolution.pdf>

## **F. Rekomandimi**

73. Parashtruesit e kërkesës dhe kërkesa i përmbushin kriteret e pranueshmërisë teknike të parapara me Rezolutën për themelimin e Panelit Inspektues dhe Qartësimin, të vitit 1999. Gjithashtu, dhe duke u bazuar në vrojtimitet e lartcekura, Paneli ka konstatuar se ekziston një lidhje e mundshme midis dëmit të pohuar në Kërkesë dhe projekteve, ashtu siç parashihet në Procedurat operative të Panelit.

74. Prandaj, Paneli rekomandon ndërmarrjen e një hetimi për çështjet e pretenduara të dëmeve dhe mos-pajtueshmërinë me politikën dhe procedurat operative të Bankës Botërore në raport me ndihmën teknike të financuar nga Banka dhe me aktivitetet e tjera, meqë ato ndërlidhen me kërkesën dhe me procesin e përgatitjes së PEK-së. Më konkretisht, hetimi do të shqyrtojë mos-pajtueshmërinë e mundshme të Bankës në lidhje me zhvendosjen e lagjes Shala të fshatit Hade dhe dëmet e pohuara në Zonën me interes të veçantë ekonomik, të pësuar nga parashtruesit e kërkesës.